

**LIGJI Nr. 04/L-076 PËR POLICINË**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR POLICINË**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.

**Neni 2  
Parimet udhëzuese**

1. Veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

- 1.1. trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave;
- 1.2. respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;
- 1.3. paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave;
- 1.4. integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik;
- 1.5. transparenca - ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut;
- 1.6. legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti;
- 1.7. përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë.

2. Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

3. Kodi i Etikës duhet të jetë në përputhje me parimet e lartpërmendura dhe me Kodin Evropian të Etikës Policore.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1.**Komision** - Komisioni i themeluar nga Ministri i Punëve të Brendshme për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Zëvendësrejtoreve të Përgjithshëm të Policisë;

1.2.**Stafi Civil** - personeli i policisë të cilët janë të punësuar për të kryer shërbime administrative apo mbështetëse por të cilët nuk kanë autorizime policore;

1.3.**Drejtorët e Departamenteve** - Drejtorët e Departamenteve të cilët udhëheqin njërin nga fushat e caktuara te nivelit qendror në Policinë e Republikës së Kosovës;

1.4.**Zëvendësrejtoret e Përgjithshëm**- Zëvendësrejtoret e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës;

1.5.**Drejtori i përgjithshëm**- Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës;

1.6.**Inspektorati** – Inspektorati Policor të Republikës së Kosovës të themeluar me Ligjin për Inspektoratin Policor;

1.7.**Objektivi i ligjshëm i Policisë** - synimi të cilin e ndjek policia gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, që është në pajtim me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

1.8.**Ministri** - Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme;

1.9.**Ministria** - Ministrinë e Punëve të Brendshme;

1.10.**Policia** - Policia e Republikës së Kosovës;

1.11.**Zyrtari Policor** - zyrtari nën betim i Policisë së Republikës së Kosovës, të cilit i është dhënë autoriteti për të ushtruar autorizime policore në kryerjen e detyrave të tij/saj;

1.12.**Autorizimet Policore** - autorizimet e zyrtarit policor që të imponoj kontroll të arsyeshëm ndaj njerëzve dhe pronës brenda juridiksionit të tij/saj për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike;

1.13.**Drejtori rajonal** - çdo drejtor rajonal i Policisë së Republikës së Kosovës, përfshirë edhe drejtorin rajonal të policisë kufitare;

1.14.**Këshilli Komunal për Siguri** - Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi të themeluar në secilën komunë të Republikës së Kosovës; dhe

1.15.**Komiteti Lokal për Siguri** - Komiteti Lokal i Sigurisë në Bashkësi të themeluar nga drejtori i përgjithshëm në komunitetin lokal në kuadër të një komune të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 4 Statusi i Policisë**

1. Me këtë ligj, Policia e Republikës së Kosovës është shërbim publik në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2. Policia është person juridik.

3. Policia vepron nëpërmjet zinxhirit të unifikuar komandues në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

4. Policia ka uniformën, flamurin dhe emblemën e vet të cilat aprovohen nga qeveria me propozimin e ministrit.

## **Neni 5**

### **Marrëdhëniet ndërmjet Policisë dhe Ministrisë**

1. Policia funksionon nën autoritetin e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Autoriteti i ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të policisë. Drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e policisë. Drejtori i përgjithshëm bashkëpunon me ministrin dhe i ofron informata dhe raporte atij sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

2. Në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, ministri ka këto të drejta:

2.1. t'i zhvilloj politikat dhe ta mbështesë përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit;

2.2. ta mbikëqyrë koordinimin ndërmjet policisë dhe autoriteteve të tjera publike lidhur me kontrollin e kalimit kufitar;

2.3. ta mbikëqyrë bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe agjencive të tjera, organizatave ndërkombëtare përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;

2.4. t'i zhvilloj dhe t'i zbatoj strategjitë për marrëdhëniet me publikun dhe marrëdhëniet me organet e tjera përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike;

2.5. të mbledh, të mbaj dhe të analizoj të dhëna statistikore dhe informata; dhe

2.6. të kryej funksione që lidhen me përgatitjet për raste emergjente, siç është përcaktuar me këtë ligj dhe ligjet e aplikueshme.

## **Neni 6**

### **Marrëdhëniet ndërmjet Policisë, Prokurorit Publik dhe Gjykatës**

1. Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara në mënyrë të ligjshme nga prokurori publik ose gjyqtari kompetent.

2. Policia bashkëpunon dhe i raporton Zyrës së Prokurorit Publik kompetent për informatat lidhur me akuzat për aktivitete të dyshimta kriminale, për të cilat policia është njoftuar në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

## **Neni 7**

### **Bashkëpunimi me komunitetin**

1. Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit dhe për shtimin e sigurisë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës, policia komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet e qeverisë lokale, organizatat civile dhe me komunitetet lokale.

2. Policia bashkëpunon me komunitetin, ndërkaq komandanti i stacionit dhe përfaqësues të tjerë policorë marrin pjesë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, të themeluar në secilën komunë.

3. Këshilli për Siguri është një organ këshillues i kryesuar nga kryetari i komunës dhe anëtarë që janë përfaqësues të të gjitha komuniteteve përbrenda komunës.

4. Qëllimi i Këshillit të Sigurisë është që ta zhvilloj vetëdijesimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikoj brengat lidhur me sigurinë publike dhe t'i rekomandoj planet e veprimit, për t'i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe policisë.

5. Drejtori i përgjithshëm është i autorizuar të themelojë Komitetin për Siguri Publike, si një organ këshillues, në kuadër të ndonjë zone të caktuar në çdo komunë që është në interesin më të mirë për një punë efektive të policisë në bashkësi.

#### **Neni 8**

#### **Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe me ato lokale të qeverisjes**

1. Policia bashkëpunon me institucione të qeverisjes qendrore të Republikës së Kosovës që janë përgjegjëse në fushën e sigurisë. Bashkëpunimi i tillë rregullohet me akte nënligjore të qeverisë dhe me memorandume të mirëkuptimit, të miratuara nga ministri.

2. Me kërkesë të institucioneve të qeverisjes qendrore ose lokale, policia është e autorizuar t'ju ofroj ndihmë në kryerjen e detyrave publike, kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose e personave që kryejnë detyra publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm ndaj veprimeve të tyre.

#### **Neni 9**

#### **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Policia bashkëpunon me organizatat policore ndërkombëtare dhe me institucionet e tjera të huaja, në bazë të ligjit në fuqi ose sipas marrëveshjes ndërkombëtare.

2. Policia mund të dërgoj zyrtarë policorë në shërbim të përkohshëm në një organizatë tjetër policore ndërkombëtare me qëllim të kryerjes së detyrave policore jashtë vendit, në përputhje me ligjin në fuqi ose në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.

### **KREU II**

### **DETYRAT DHE AUTORIZIMET E POLICISË**

#### **Neni 10**

#### **Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë**

1. Detyrat e përgjithshme të policisë janë të:

- 1.1. mbrojt jetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat;
- 1.2. mbrojt të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave;
- 1.3. parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- 1.4. parandaloj dhe t'i zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre;
- 1.5. hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre;
- 1.6. mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion;
- 1.7. menaxhoj dhe kontrolloj kufirin shtetëror;
- 1.8. ofroj ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- 1.9. kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.

## **Neni 11**

### **Autorizimet policore**

1. Gjatë kryerjes së detyrave policore, zyrtari policor ka autorizim të ushtrijë kontroll të arsyeshëm mbi njerëzit dhe pronën në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij apo të saj, të jap dhe të zbatoj urdhra dhe instruksione të ligjshme për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi, për t'i arritur objektivat ligjore të policisë.
2. Autorizimet e cekura në këtë ligj përcaktojnë autorizimet e përgjithshme dhe kufizimet e zyrtarit policor në kryerjen e detyrave të tij lidhur me parandalimin e rrezikut dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike. Autorizimet dhe kufizimet e zyrtarit policor gjatë ushtrimit të detyrave përkitazi me hetimet penale, në mënyrë të përgjithshme, janë përcaktuar në ligjet e tjera, duke i përfshirë, por jo duke u kufizuar, në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
3. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, zyrtarët policorë, kanë autorizim të patrollojnë kufirin, ta kontrollojnë trafikun ndërkufitarë, t'i ekzaminonjë dokumentet për kalimin e kufirit, të hyjnë në pronën private në zonën kufitare, përjashtimisht ata nuk mund të hyjnë në banesa private, por mund të hyjnë në stacione hekurudhore, aeroporte, trena dhe në aeroplanë. Policia ka të drejtë të njihet me pronarin e pronës përgjatë kufirit, të ketë rrugë apo shteg përgjatë vijës kufitare dhe porta në murin rrethues për t'iu mundësuar qasje zyrtarëve policorë gjatë patrullimit.
4. Policia ofron siguri dhe mbrojtje për vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Republikën e Kosovës.
5. Zyrtari policor ushtron autorizimet policore edhe jashtë orarit të punës në pajtim me ligjin.

## **Neni 12**

### **Përshtatshmëria dhe proporcionaliteti**

1. Zyrtari policor zbaton parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit si një kufizim në ushtrimin e autorizimeve policore.
2. Kur ndërmerr masa parandaluese për ta kufizuar lirinë e personit, zyrtari policor duhet ta ketë parasysh maturinë, shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e kryerjes së veprës penale në atë situatë, për ta përcaktuar shkallën e kufizimit të lirisë së personit në pajtim me ligjin.
3. Autorizimet e policisë ushtrohen vetëm atëherë kur është e domosdoshme, dhe vetëm deri në atë nivel që nevojitet për t'i arritur objektivat ligjore të policisë me pasoja sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme.

## **Neni 13**

### **Detyra e zyrtarit policor për t'i zbatuar urdhrat e ligjshëm dhe për t'i refuzuar urdhrat e paligjshëm**

1. Zyrtari policor ka për detyrë t'i zbatoj urdhrat e ligjshëm të dhëna nga mbikëqyrësi.
2. Zyrtari policor ka për detyrë t'i refuzoj urdhrat të cilët janë të paligjshëm dhe të raportoj për këtë menjëherë në pajtim me aktet nënligjore.
3. Zyrtari policor nuk do të shkaktoj, nxis, mbështes ose toleroj asnjë akt të torturës, degradimit ose trajtimit çnjerëzor në çfarëdo rrethanash, ndërsa asnjë rrethanë e jashtëzakonshme apo urdhër i lëshuar nuk do ta arsyetojë veprimin e tillë.

#### **Neni 14**

##### **Prezantimi i zyrtarit policor**

1. Para se t'i ushtroj autorizimet policore, zyrtari policor do t'i njoftoj personat lidhur me statusin e tij/saj si zyrtar policor dhe, nëse nuk është në uniformë, duhet të prezantohet veten duke treguar kartelën e identifikimit ose shenjën e policisë.
2. Zyrtari policor do të prezantohet më vonë në rastet kur vihet në rrezik jeta, prona ose arritja e objektivave legjitime të policisë.

#### **Neni 15**

##### **Pranimi i informatave për veprat penale dhe shkeljet e tjera të ligjit**

1. Zyrtari policor ka për detyrë t'i pranojë informatat e ofruara nga personat lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale ose me shkeljet e tjera të ligjit që janë relevante për punën dhe kompetencat e policisë.
2. Kur policia konstaton se vepra e raportuar nuk është vepër penale apo është vepër penale e cila ndiqet në bazë të padisë private, zyrtari policor duhet ta informojë personin që ka raportuar dhe palën e dëmtuar nëse ekziston ajo.
3. Informatat për vepra penale përcillen në Zyrën e Prokurorit Publik kompetent në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.

#### **Neni 16**

##### **Identifikimi i personave dhe i sendeve**

1. Zyrtari policor ka autorizim ta identifikoj personin tjetër atëherë kur:
  - 1.1. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë vepër penale;
  - 1.2. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi paraqet rrezik për personat ose pronën, ose është duke shkaktuar shqetësim;
  - 1.3. gjendet në zonën në të cilën është kryer, është duke u kryer ose ku do të kryhet vepra penale, apo zonën ku është duke u fshehur i dyshuari;
  - 1.4. gjendet në vend të ndaluar sipas ligjit në fuqi;
  - 1.5. personi gjendet në vend të ngjarjes, në zonë të kufizuar ose në kufi;
  - 1.6. duhet të arrestohet ose të paraburgoset;
  - 1.7. është i autorizuar të ndërmarrë një veprim të tillë në bazë të cilitdo ligj tjetër në fuqi.
2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, zyrtari policor është i autorizuar ta ndalë personin, ta pyes për identitetin e tij dhe të kërkojë ndonjë dokument valid identifikimi me fotografi. Zyrtari policor do t'ia tregojë personit shkakun e identifikimit. Kur personi nuk bashkëpunon dhe masat e tjera dështojnë për ta përcaktuar identitetin e tij, zyrtari policor mund ta ndalojë personin, duke i zbatuar procedurat e parapara me ligjin në fuqi, për ta vërtetuar identitetin e tij.
3. Ndalimi zgjatë vetëm aq kohë sa është e domosdoshme për t'u kryer identifikimi, por jo më gjatë se gjashtë (6) orë. Zyrtari policor do ta përpilojë raportin për procedurën e identifikimit dhe një kopje të tij do t'ia japë personit që është në mbajtje nëse kërkohet nga ai/ajo.

4. Zyrtari policor është i autorizuar ta vërtetojë ose ta përcaktojë identitetin e një sendi. Ky autorizim do të ushtrohet kur është e domosdoshme të përcaktohet vlera e një sendi, karakteristikat, pronësia ose për ta përcaktuar lidhjen e sendit me personin, ngjarjen ose me veprimin. Policia është e autorizuar ta publikoj fotografinë, skicën, regjistrimin ose përshkrimin e sendit, nëse ekziston bindje e arsyeshme se ky veprim do të ndihmojë në përcaktimin e identifikimit të sendit.

### **Neni 17** **Thirrjet e policisë**

1. Zyrtari policor mund ta thërrasë personin për të dhënë informacione nëse ka arsye të bazuar se personi i caktuar ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitimë të policisë. Përgjigjja ndaj një ftese të tillë është vullnetare nga personi që e pranon ftesën.

2. Zyrtari policor është i autorizuar që ta thërrasë gojarisht personin e caktuar për intervistë në polici, nëse ekziston arsye e bazuar se ai ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të policisë.

3. Zyrtari policor duhet ta njoftoj personin lidhur me arsyen e thirrjes, dhe nëse personi pajtohet, zyrtari policor e shoqëron atë për në lokalet e policisë. Në raste urgjente, kur vonesa shkakton rrezik ose janë thirrur shumë njerëz, atëherë thirrja mund të publikohet në mediat publike.

4. Zyrtari policor është i autorizuar që me shkrim ta thërrasë personin e caktuar për intervistë në polici, nëse ekziston arsyeja e bazuar se personi ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të policisë. Fletëthirrja do të përmbajë titullin, adresën dhe vendin e organit policor që bën kërkesë për prezencën e personit, arsyen për thirrje, vendin dhe kohën ku duhet të paraqitet personi i thirrur.

5. Intervista policore për të miturit zhvillohet vetëm atëherë kur prindi ose kujdestari ka nënshkruar fletëthirrjen dhe e ka miratuar atë dhe vetëm në praninë e prindit ose të kujdestarit. Përgjigjja ndaj fletëthirrjes është vullnetare nga personi i thirrur.

6. Zyrtari policor lëshon fletëthirrje që personi i kërkuar të paraqitet për intervistë policore vetëm gjatë orarit ditor të punës, me përjashtim kur vonesa e thirrjes paraqet rrezik për personin, pronën, ose për arritjen e objektivave legjitime të policisë.

7. Vetëm sipas urdhrin të gjykatës dhe vetëm në pajtim me ligjin e aplikueshëm, zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbajtur personin e thirrur dhe për ta sjellë në stacionin policor ose në ndonjë vend tjetër. Nëse përdoret forca gjatë procesit të thirrjes, personi i thirrur informohet në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, se ka të drejtë të hesht, ta konsultoj mbrojtësin dhe ta kontaktoj një person familjar apo ndonjë person tjetër të besueshëm, siç parashihet në Kodin e Procedurës Penale.

### **Neni 18** **Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes**

1. Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht t'ia kufizojë lirinë e lëvizjes personit në një zonë të caktuar ose ta orientojë lëvizjen e tij në një zonë tjetër, me qëllim që të sigurohet zona e caktuar për t'i arritur objektivat legjitime të policisë apo për t'i mbrojtur personat nga rreziku i përkohshëm.

2. Objektivat legjitime të policisë përfshijnë, por nuk kufizohen në mbrojtjen e personave nga fatkeqësitë, epidemitë, dhe rastet e tjera të rrezikut të pashmangshëm.

3. Kufizimi i përkohshëm i lirisë së lëvizjes të personit përfundon menjëherë pasi të arrihen objektivat legjitime të policisë lidhur me kufizimin e përkohshëm.

## **Neni 19**

### **Vërejtjet dhe urdhrat**

1. Zyrtari policor është i autorizuar të jap vërejtje gojore, me shkrim, vizuale ose vërejtje të tjera ndaj çdo personi që paraqet rrezik për sigurinë personale apo publike, paraqet rrezik për pronën private apo publike, prish rendin dhe qetësinë publike, paraqet rrezik për sigurinë në komunikacion ose ekziston dyshimi i bazuar se është duke kryer apo duke u përgatitur për të kryer një vepër penale ose është duke e detyruar personin tjetër të kryejë vepër penale.
2. Zyrtari policor është i autorizuar t'u jap urdhra personave të tillë në mënyrë që t'i ndalojë veprimet e tyre ose të ndërmarrë veprime të tjera të cilat zyrtari policor i konsideron të arsyeshme.
3. Vërejtjet dhe urdhrat mund të jepen me qëllim të arritjes së objektivave legjitime të policisë duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në kushtet e parapara në nenin 11 të këtij ligji.

## **Neni 20**

### **Ndalimi i përkohshëm policor**

1. Zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin atëherë kur është e nevojshme:
  - 1.1. ta mbroj personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s'ka mundësi për t'u mbrojtur; apo
  - 1.2. ta identifikoj personin ose t'i kufizoj lëvizjet e tij, siç autorizohet me ligj, kur personi është jo bashkëpunues ndaj masave më të lehta.
2. Ndalimi i përkohshëm policor zgjatë aq sa është e nevojshme që të arrihen objektivat legjitime të policisë, por jo më gjatë se gjashtë (6) orë, përjashtimisht në rastet kur personi është ende në gjendje të pamundësisë për t'u mbrojtur, por jo edhe më gjatë se gjashtë (6) orë të tjera.
3. Ndalimi i përkohshëm policor në pajtim me nën-paragrafin 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni mund të zgjasë deri njëzetekatër (24) orë, brenda këtij afati policia obligohet ta informojë prokurorin publik kompetent në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.
4. Personi nën ndalim të përkohshëm policor në pajtim me këtë nen nuk mbahet së bashku me të burgosurit, personat e arrestuar dhe të paraburgosurit e tjerë, me personat e gjinisë së kundërt dhe me persona të mitur përveç nëse vetë janë të mitur.
5. Personi nën ndalim të përkohshëm informohet lidhur me arsyet e mbajtjes, dhe i jepet mundësia ta lajmëroj ndonjë anëtar të familjes, mbrojtësin, institucionin përkatës ose personin tjetër të besueshëm.
6. Nëse personi në mbajtje është i paaftë për të vepruar, zyrtari policor përpiqet që ta njoftojë një anëtar të familjes ose ndonjë person tjetër të besueshëm, përveç nëse një gjë e tillë do të ishte në dëm të personit në mbajtje.

## **Neni 21**

### **Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve**

1. Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht ta sekuestroj një send me qëllim që ta parandalojë rrezikun e menjëhershëm ndaj personave apo pronës, për ta mbrojtur pronarin apo poseduesin e ligjshëm nga humbja ose dëmtimi i sendit, apo në përputhje me ligjin në fuqi, ta mbajë në vend të sigurt, përderisa personi të mbahet në paraburgim. Nëse dihet, pronari ose poseduesi i ligjshëm i sendit, do të informohet për arsyen e sekuestrimit të përkohshëm dhe do t'i jepet vërtetimi përkatës.

2. Sendin e sekuestruar policia e mban vetëm aq kohë sa është e nevojshme për t'i arritur objektivat ligjor të saj, por jo më gjatë se dhjetë (10) ditë, të cilin pastaj ia kthen pronarit ose poseduesit të ligjshëm sa më shpejtë që të jetë e mundshme.

3 Kufizimet e parapara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, zbatohen përshtatshmërisht për sekuestrim të përkohshëm në pajtim me këtë nen.

## **Neni 22**

### **Kontrolli parandalues**

1. Zyrtari policor është i autorizuar të kryej me iniciativë të tij/saj kontroll me qëllim të parandalimit të rrezikut të menjëhershëm ndaj sigurisë publike, jetës dhe pronës, kontroll parandalues të personave, objekteve, hapësirave dhe vendeve të caktuara, kur ekziston dyshimi i arsyeshëm që veprat e kryera mund të rrezikojnë jetën apo pronën në pajtim me kufizimet e parapara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

2. Kontrolli parandalues, në kuptimin e këtij neni, zbatohet me qëllim të largimit të armëve, apo sendeve tjera që paraqesin rrezik të pashmangshëm për jetën ose pasurinë, apo të parandaloj aktivitetet të cilat paraqesin rrezik të pashmangshëm për jetën dhe pasurinë. Kontrolli mund të përfshijë përdorimin e mjeteve teknike dhe të tjera për të zbuluar eksploziv, materie kimike, biologjike apo materiale radioaktive.

3. Pas ushtrimit të kontrollit, zyrtari policor harton procesverbal përkatës dhe brenda dyzetetë (48) orëve, duke përjashtuar rrethanat e jashtëzakonshme të njëjtin ia dërgon prokurorit publik kompetent për vendin ku është kryer kontrolli. Një kopje e procesverbalit duhet t'i jepet pronarit ose poseduesit të objektit apo personit të kontrolluar. Personat e kontrolluar nga policia, kanë të drejtë të bëjnë ankesë në gjykatën kompetente, nëse e konsiderojnë kontrollimin e tyre nga policia si të padrejtë apo në kundërshtim me ligjin.

## **Neni 23**

### **Ndalimi dhe kontrolli i mjetit motorik**

1. Zyrtari policor gjatë ushtrimit të detyrave të tij të parapara me ligjet në fuqi është i autorizuar të jap urdhra, ndaloj dhe të kontrolloj mjetin motorik, në pajtueshmëri me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

2. Bazuar në dyshimin e arsyeshëm, zyrtari policor është i autorizuar të kontrolloj mjetin motorik në rast se:

2.1. mjeti motorik është përdorur për të kryer vepra penale apo mjeti është i ndërlidhur me veprën penale;

2.2. të kërkimit të personave, armëve, municionit, materialit eksploziv, drogave ose përbërësve, materieve tjera të rrezikshme ose sendeve që ndërlidhen me veprën penale.

## **Neni 24**

### **Sigurimi dhe këqyrja e vendit të ngjarjes së veprës penale apo aksidentit**

1. Zyrtari policor është i autorizuar ta sigurojë dhe ta shikoj vendin e ngjarjes të veprës penale ose aksidentit, derisa të vij organi përgjegjës, që të gjejë dhe të siguroj dëshmi, të zbuloj kryesin e veprës penale dhe të mbledh informacione lidhur me veprën penale ose aksidentet.

2. Më qëllim të mbrojtjes së viktimave të veprës penale apo të aksidentit, zyrtari policor është i autorizuar ta pengojë incizimin video-akustik në perimetrin e sigurisë të vendit të ngjarjes të veprës penale apo aksidentet.

## **Neni 25**

### **Vëzhgimi parandalues i vendit publik**

1. Policia është e autorizuar të bëjë vëzhgim parandalues të vendit publik, duke përdorë pajisje për incizime video-akustike dhe pajisje fotografike për t'i vëzhguar vendet publike ku në të kaluarën shpesh janë kryer vepra penale, apo ku ka arsye të bazuar të besohet se vëzhgimi publik do ta zvogëlonte rrezikun nga kryerja e veprave penale dhe do ta përmirësonte sigurinë publike në të ardhmen, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale.
2. Policia është e autorizuar t'i përdorë incizimet video-akustike dhe fotografitë për të vëzhguar dhe mbledhur informacione në një tubim publik atëherë kur ka arsye të bazuar se tubimi publik mund t'i rrezikoj personat apo pronën.
3. Para se të ndërmerret vëzhgimi parandalues, në përputhje me këtë nen, policia do ta informoj publikun për qëllimin dhe arsyen e ndërmarrjes së këtij aktiviteti, përveç nëse kjo mund ta pengoj qëllimin apo rezultatin e vëzhgimit.
4. Incizimet video dhe audio nga vëzhgimi parandalues do të mbahen jo me gjatë se tridhjetë (30) ditë nga dita e incizimit, përveç kur pas kontrollimit, verifikohet se incizimi përmban të dhëna për veprimtari kriminale. Mbajtja e këtyre të dhënave më gjatë se kjo periudhë bëhet vetëm në rastet e parapara me ligjin në fuqi.

## **Neni 26**

### **Përdorimi i forcës**

1. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë forcën, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të policisë.
2. Zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbrojtur jetën e personit, për ta parandaluar sulmin, kryerjen e veprës penale, arratisjen e kryesit të veprës apo atëherë kur masat e tjera nuk janë të suksesshme për arritjen e një objekti tjetër legjitim të policisë.
3. Zyrtari policor vepron me maturinë e tij/saj për ta përcaktuar llojin e forcës më të përshtatshme dhe kufizimet në përdorimin e forcës. Zyrtari policor merr parasysh rrethanat specifike, natyrën e veprës penale, shkallën e rrezikut ndaj personave të tjerë që janë të pranishëm dhe gjendjen fizike, mentale dhe emocionale të personit ndaj të cilit përdoret forca.
4. Në rastet e përdorimit të forcës, zyrtari policor duhet të përpiqet ta minimizoj ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e personit dhe të minimizoj çfarëdo pasoje të dëmshme.
5. Përdorimi i forcës, si term që përdoret në këtë ligj, përfshin por nuk kufizohet vetëm në përdorimin e forcës fizike, shufrës zyrtare, sprejit, mjeteve pranguese, mjeteve për ndalimin e automjeteve, qenit të policisë, mjeteve kimike për paaftësim të përkohshëm, kalit të policisë, armëve të zjarrit, topave të ujit, automjeteve dhe llojeve të veçanta të armëve dhe mjeteve shpërthyes.

## **Neni 27**

### **Përdorimi i armëve të zjarrit**

1. Zyrtari policor është i autorizuar të posedoj dhe ta bartë armën zyrtare të zjarrit të lejuar nga policia. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për ta arritur objektivin ligjor të policisë, kur përdorimi i saj është në proporcion me shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e veprës penale në atë situatë, dhe vetëm nëse konsiderohet se me përdorimin e mjeteve më të vogla të forcës nuk do të arrihen objektivat legjitime të policisë.

2. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër personit tjetër vetëm kur mjetet më pak ekstreme janë të pamjaftueshme që ta:

2.1. mbroj jetën e vet ose jetën e të tjerëve nga sulmet e pashmangshme;

2.2. parandaloj kryerjen e pashmangshme apo vazhdimësinë e veprës penale që shkakton rrezik të lartë për jetën;

2.3. arrestoj personin i cili paraqet rrezik për jetën e të tjerëve dhe që u reziston urdhrave ligjor të dhënë nga zyrtari policor; dhe

2.4. parandaloj arratisjen e personit i cili paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor.

3. Para se ta përdorë armën e zjarrit, zyrtari policor jep vërejtje gojore, prezanton vetën si zyrtar policor, duke urdhëruar personin që të ndalet, por edhe duke e paralajmëruar se do të shtie nëse ai/ajo nuk ndalet.

4. Si masë e veçantë në rrethana urgjente, zyrtari policor mund të mos e bëjë paralajmërimin në rast se një veprim i tillë e rrezikon zyrtarin policor ose personat e tjerë nga një rrezik serioz i pashmangshëm.

5. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër kafshëve, kur ato paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e cilitdo person, ose për shkak të rrezikut nga sulmi.

#### **Neni 28**

##### **Përdorimi i pronës së personave të tretë në rrethana urgjente**

1. Zyrtari policor është i autorizuar që përkohësisht ta marrë apo ta përdorë çfarëdo prone, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mjetet e transportit, të komunikimit ose të mbrojtjes, që janë në posedim të cilitdo qytetar, mirëpo vetëm atëherë kur është e domosdoshme që të parandalohet rreziku i pashmangshëm për personat ose pronën apo për të arritur një objektiv tjetër policor urgjent, që kërkon veprim të menjëhershëm.

2. Prona që merret në përdorim duhet t'i kthehet personit nga i cili është marrë menjëherë pasi të mos jetë më e nevojshme që të arrihen objektivat urgjent policor për çka edhe është marrë, por në asnjë rast jo më gjatë se njëzetekatër (24) orë pas marrjes. Policia do ta kompensoj pronarin apo poseduesin për çdo shpenzim apo dëm që i është shkaktuar pronës gjatë përdorimit të saj.

#### **Neni 29**

##### **Burimet e besueshme të informatave**

1. Zyrtari policor do t'i pranoj dhe vlerësoj të gjitha informatat e marra nga individët anonimë që janë relevante për kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë.

2. Zyrtari policor mund të krijoj marrëdhënie bashkëpunuese të besueshme me personat më qëllim që të marrë informata relevante që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave policore dhe arritjen e objektivave legjitime të policisë.

3. Zyrtari policor do ta mbroj besueshmërinë e marrëdhënieve të tilla bashkëpunuese dhe të informacioneve të marra përderisa obligimi ligjor për ta ruajtur besueshmërinë të jetë përmbushur.

#### **Neni 30**

##### **Njoftimi publik për shpërblimin**

1. Policia është e autorizuar të ofrojë shpërblime për dhënien e informatave relevante që shkojnë në dobi të kryerjes së detyrave policore dhe për arritjen e objektivave legjitime të policisë. Ofertat e tilla për

shpërblime do të shpallen publikisht në gazeta, radio, televizione ose në media të tjera përkatëse apo në mënyra të tjera.

2. Shpërblimi i tillë jepet vetëm nëse informatat e marra ende nuk janë në duart e policisë dhe vetëm atëherë kur marrja e këtyre informatave shpie në arritjen e objektivave legjitime të policisë, për çka edhe është marrë informata.

### **Neni 31**

#### **Mbledhja, ruajtja, procedimi, analizimi, përdorimi dhe fshirja e të dhënave**

1. Policia është e autorizuar t'i mbledh dhe t'i ruaj të dhënat personale, të dhënat mbi krimin dhe të dhënat e tjera. Të dhënat personale janë të dhënat që kanë të bëjnë me një person të identifikuar apo të identifikueshëm që përfshijnë, por nuk kufizohen në emër, datëlindje, vendin e lindjes dhe në vendbanimin. Të dhënat e krimit janë të dhëna që kanë të bëjnë me vepra të caktuara penale që përfshijnë, por nuk kufizohen në llojin e veprës penale, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës, metodat dhe mënyrat e përdorura për kryerjen e veprës, çfarëdo lëndime të personave apo dëmin e pasurisë që është pasojë e veprës penale dhe motivin e saj.

2. Mbledhja, ruajtja, përdorimi dhe transferimi i të dhënave personale bëhet në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Policia mbledh dhe ruan të dhënat personale dhe të dhënat e veprave penale vetëm për analiza dhe përdorim në mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike, zbulimin dhe parandalimin e veprave penale, në identifikimin, vendndodhjen dhe në kapjen e kryesve të veprave penale dhe për arritjen e objektivave të tjera legjitime të policisë.

4. Policia ruan të dhënat personale vetëm deri në atë masë kur ekziston arsyetimi i bazuar se ruajtja e informatave do të ndihmoj në arritjen e objektivave legjitime të policisë. Kufizimet e arsyeshme në llojin e informatave të ruajtura, në kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave personale në regjistrat e policisë dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave do të rregullohen me akte nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Policia nuk duhet të mbledh dhe të ruaj informata dhe të dhëna personale për personat me qëllim të mirëmbajtjes së regjistrave që kanë të bëjnë me bindjet apo anëtarësimet politike, religjioze apo filozofike.

6. Zyrtari policor ka për detyrë ta ruaj besueshmërinë e të gjitha të dhënave personale dhe të dhënave të krimit të cilat ai apo ajo i ka marrë gjatë kryerjes së detyrave policore, përveç në ato raste kur lirimi i të dhënave autorizohet me ligj dhe është e nevojshme për të arritur objektivin legjitim të policisë.

7. Policia siguron mbikëqyrje kompetente për sistemin e informatave ku regjistrat policor mbahen me qëllim të mbrojtjes së të dhënave personale në pajtim me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Të dhënat numerike që kanë të bëjnë me veprat penale, kryesit e veprave, viktimat apo me kategori të tjera që lidhen me veprën penale apo me sigurinë, mund të përdoren për qëllime statistikore apo analitike nga policia apo ministria. Të dhënat e tilla do të jenë të mundshme për përdorim edhe nga autoritetet hulumtuese profesionale apo akademike.

9. Të dhënat personale mund t'u jepen edhe organizatave të huaja dhe atyre ndërkombëtare policore në bazë të ligjit në fuqi.

10. Policia siguron me kërkesën e ndonjë personi, çfarëdo të dhëna personale të ruajtur nga policia lidhur me personin që bën kërkesën, përveç nëse në ato raste dhënia e të dhënave mund t'i dëmtoj hetimet ose kur interesi i besueshmërisë nga personi tjetër ose publiku është më i rëndësishëm se

interesi i zbulimit të personit që ka bërë kërkesën. Pas zbulimit se të dhënat personale të ruajtura në regjistrë janë jo të sakta, policia do t'i korrigjoj apo largoj ato të dhëna personale.

### **KREU III ORGANIZIMI I POLICISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Neni 32 Organizimi i Policisë së Republikës së Kosovës**

1. Policia organizohet në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Niveli lokal përfshin Drejtoritë Rajonale të Policisë, përgjegjëse për rajonet e përbëra me komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilën komunë dhe nënstacionet policore, përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune.
2. Juridiksioni territorial i secilës drejtori rajonale përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Juridiksioni territorial i secilit stacion policor do të jetë brenda kufijve të komunës, ku është vendosur. Juridiksioni territorial i secilit nënstacion policor përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
3. Struktura e brendshme organizative e Policisë së Republikës së Kosovës propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe aprovohet nga ministri. Drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e ministrit, mund të themeloj njësitë policore të përkohshme për të kryer detyra të veçanta.
4. Më qëllim të menaxhimit dhe kontrollit të kufijve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, përveç stacioneve policore që gjenden në secilën komunë, themelon edhe stacionet policore kufitare nën autoritetin dhe juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare.

#### **Neni 33 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe përbëhet nga departamente, sipas fushave përkatëse.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka këto detyra dhe përgjegjësi të:
  - 2.1. përkrahë Drejtorin e Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj;
  - 2.2. mbikëqyrë efektivitetin e Drejtorive Rajonale të Policisë;
  - 2.3. menaxhoj, vëzhgoj, analizoj dhe vlerësoj situatën e tërësishme të sigurisë;
  - 2.4. udhëheqë veprimet policore në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente;
  - 2.5. koordinoj zhvillimin dhe implementimin e strategjive për parandalimin dhe zvogëlimin e krimit, rivendosjen dhe mbajtjen e rendit dhe të sigurisë publike dhe për sigurimin dhe kontrollin e kufijve;
  - 2.6. koordinoj funksionet administrative të policisë, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në mirëmbajtjen e të dhënave të policisë dhe sistemin e telekomunikimit, rekrutimit, trajnimit dhe të edukimit të personelit policor, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare, prokurimin dhe në menaxhimin e rasteve dhe objekteve policore;
  - 2.7. bashkëpunoj me organizata ndërkombëtare dhe ta koordinoj implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me aktivitetet policore; dhe të

2.8. kryej punë të tjera të parapara me ligj, rregulla ligjore, me instruksione apo urdhra.

3. Selia e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Republikës së Kosovës do të jetë e vendosur në Prishtinë.

#### **Neni 34 Drejtoritë Rajonale të Policisë**

1. Në mënyrë që veprimet policore të menaxhohen me efektivitet, Policia e Republikës së Kosovës ndahet në rajone të cilat, kurdo që të jenë të njëjta me kufijtë rajonal të gjyqësisë.

2. Në përcaktimin e juridiksionit territorial të drejtorive rajonale, konsideratë do t'ju jepet faktorëve ashtu siç janë, mirëpo jo të kufizuar në madhësinë e rajonit, numrin e banorëve, nivelin e krimit, pozitën gjeografike, ndërtesat e rëndësishme, rrugët dhe në infrastrukturën tjetër.

3. Funksionet e Drejtorisë Rajonale përfshijnë por nuk do të kufizohen vetëm si në vijim të:

3.1. kryej detyra dhe funksione të përcaktuara me ligj, udhëzime ose urdhra të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë;

3.2. përkrahë dhe mbikëqyrë efektshmërinë policore përbrenda rajonit ku shërben; dhe

3.3. koordinoj detyra të ndryshme që mund të caktohen nga Drejtoria e Përgjithshme, siç janë edukimi profesional dhe trajnimi për zyrtarët policorë dhe stafin ose punët administrative lidhur me financat, objektet dhe pajisjet.

#### **Neni 35 Stacionet Policore Lokale**

1. Stacionet Policore themelohen në secilën komunë, ndërsa juridiksioni territorial i stacionit policor është i njëjtë me kufijtë e komunës të përcaktuar me ligj.

2. Stacionet Policore kryejnë detyra policore në kuadër të juridiksionit të tyre brenda territorit komunal. Secilin stacion policor e udhëheq komandanti i stacionit.

3. Drejtori Rajonal mund t'ia propozojë për miratim Drejtorit të Përgjithshëm, themelimin e nënstacioneve policore, njërive të tjera organizative në kuadër të stacioneve policore.

4. Përbërja etnike e policisë në kuadër të komunës, deri në nivelin e mundshëm, do ta përfaqësojë përbërjen etnike të popullatës të asaj komune.

5. Para ndërmarrjes së çdo veprimi nga forcat policore qendrore apo speciale në kuadër të juridiksionit territorial të stacionit policor, komandanti i stacionit do të informohet nga drejtori i përgjithshëm, drejtori rajonal i policisë, apo nga zyrtarët e tjerë policorë që kryejnë veprime të veçanta, përveç nëse rrethanat operacionale kërkojnë ndryshe.

#### **Neni 36 Themelimi i Policisë Rezervë**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, me aprovimin e ministrit, themelon policinë rezervë në mënyrë që ta ndihmojë policinë në veprimet e veçanta të sigurisë. Policia rezervë përbëhet nga vullnetarët të cilët e nënshkruajnë kontratën me policinë që të jenë anëtarë rezervë, dhe janë të kualifikuar dhe të trajnuar të kryejnë detyra policore.

2. Anëtarët e policisë rezervë mund të angazhohen nga Drejtori i Përgjithshëm me aprovimin e ministrit. Menaxhimi operacional i Policisë rezervë është e drejtë vetëm e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Zyrtarët e policisë rezervë mund të angazhohen në kombinim me zyrtarët e rregullt policorë në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente, siç janë: rastet emergjente publike të rëndësishme, reagimi emergjent ndaj sulmeve terroriste, çrregullimet ose trazirat e mëdha të qytetarëve, reagimet emergjente ndaj rrezikut të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

## **KREU IV MENAXHMENTI I LARTË I POLICISË**

### **Neni 37**

#### **Komisioni për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm të Policisë**

1. Kandidatët për pozitat e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm të Policisë, përzgjidhen dhe propozohen nga komisioni, i cili themelohet nga ministri.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Policisë, emërohen për një periudhë kohore prej pesë (5) vjetësh, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vjet, nga autoriteti që i ka emëruar.
3. Nëse Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm të Policisë iu përfundon mandati në vitin kalendarik të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë qëndrimi i tyre në detyrë do të zgjatet në mënyrë automatike për një (1) vit pas certifikimit të zgjedhjeve.
4. Komisioni i propozon ministrit kandidatët për emërim në pozitën Drejtor i Përgjithshëm i Policisë, ministri në njërën nga mbledhjet e Qeverisë i propozon kandidatin Qeverisë për këtë pozitë, ndërkaq Qeveria i rekomandon kryeministrit kandidatin për Drejtor të Përgjithshëm të Policisë. Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë e emëron Kryeministri.
5. Komisioni i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, kandidatët për emërim në pozitat e Zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm të Policisë, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Policisë i rekomandon ministrit kandidatët për Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Policisë. Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Policisë i emëron ministri.
6. Drejtorët e Departamenteve duhet të zgjidhen nga Drejtori i Përgjithshëm në bazë të procedurave të brendshme të Policisë së Republikës së Kosovës.
7. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë është përgjegjës që të udhëheqë, kontrolloj, dhe mbikëqyrë policinë, të menaxhoj dhe shpërndaj buxhetin e policisë në përputhje me objektivat dhe qëllimet strategjike të përcaktuara nga ministri.
8. Themelimi, përbërja dhe procedura e komisionit rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri.

### **Neni 38**

#### **Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm**

1. Kriteret për përzgjedhje dhe emërim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm janë:
  - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. të jetë i diplomuar në një nga universitetet e akredituara ose të ketë diplomë të nostrifikuara.

1.3. të ketë gradën policore kolonel, nënkolonel ose major, se paku pesë (5) vite;

1.4. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;

1.5. të mos jetë ndëshkuar për shkelje të rënda disiplinore sipas rregullores disiplinore të policisë apo rregullores së institucioneve të tjera shtetërore brenda dhjetë(10) viteve të fundit që është ekuivalente me shkeljet që përcaktohen në rregulloren e disiplinës së Policisë së Kosovës;

1.6. të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo siç parashihet në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

2. Secili kandidat për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm, duhet t'i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit të aplikueshëm.

### **Neni 39**

#### **Lirimi apo shkarkimi nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm apo Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, lirohen apo shkarkohen nga detyra nga autoriteti i cili i ka emëruar, për njërin nga arsyet e mëposhtme:

1.1. është dënuar për vepër penale,

1.2. arrin moshën për pension;

1.3. jep dorëheqje;

1.4. për shkak të pamundësisë së ushtrimit të detyrës për një periudhë kohore jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj;

1.5. me mbarimin e mandatit;

1.6. për shkak të performancës jo të mirë të dokumentuar.

2. Kur ekziston dyshim i arsyeshëm për të besuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, ka kryer vepër penale apo për ndonjërin nga arsyet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni, ministri mund të suspendojë menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm dhe ia paraqet kryeministrit të gjitha faktet për dhënien e suspendimit. Kryeministri vendos lidhur me vazhdimin apo ndërprerjen e suspendimit.

3. Në rastet e liritimit, shkarkimit apo suspendimit të Drejtorit të Përgjithshëm, kryeministri menjëherë emëron njërin nga Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm si ushtrues detyre të Drejtorit të Përgjithshëm.

### **Neni 40**

#### **Drejtorit Rajonal i Policisë**

Drejtorët Rajonalë të Policisë caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm bazuar në standardin e gradave, pozitave dhe përshkrimin të vendeve të punës në polici.

### **Neni 41**

#### **Komandantët e Stacioneve Policore**

Komandantët e Stacioneve të Policisë caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm bazuar në procedurat e brendshme të Policisë.

## **Neni 42**

### **Përzgjedhja e veçantë e Komandantëve të Stacionit**

1. Në komunat ku komuniteti serb është komuniteti më i madh etnik, komandantët e stacioneve policore dhe komandantët e nënstacioneve i emëron Ministria e Punëve të Brendshme me propozimin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorit të Përgjithshëm, në pajtim me dispozitat e këtij neni.

2. Kur pozita e komandantit të stacionit ose komandantit të nënstacionit lirohet, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia dërgojë një kërkesë me shkrim Kuvendit Komunal të komunës në të cilën gjendet stacioni ose nënstacioni policor në fjalë. Bashkë me kërkesën, Drejtori i Përgjithshëm do të dërgojë edhe një listë me të gjithë kandidatët e përshtatshëm për pozitën. Drejtori i Përgjithshëm do të kërkojë nga Kuvendi Komunal të rekomandoj së paku dy (2) kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret minimale për pozitë nga lista. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës, Kuvendi Komunal do t'ia rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm së paku dy (2) kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret minimale nga kjo listë dhe mund t'i renditë ata sipas preferencës. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të rekomandimeve, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia përcjellë Ministrisë së Punëve të Brendshme emrat e të gjithë kandidatëve të rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Drejtori i Përgjithshëm mund ta shpreh preferencën e tij për emrat e rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Ministria e Punëve të Brendshme do ta emëroj një kandidat nga emrat e rekomanduar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të listës, përveç nëse aplikohet paragrafi 3. i këtij neni.

3. Nëse asnjëri nga kandidatët e rekomanduar nuk është i pranueshëm për Ministrinë e Punëve të Brendshme, ajo do ta njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm pa vonesë. Brenda shtatë (7) ditëve pas njoftimit për këtë refuzim Drejtori i Përgjithshëm do ta njoftoj Kuvendin Komunal me shkrim dhe do të kërkojë nga ata së paku dy rekomandime shtesë për pozitën. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kësaj kërkesë, Kuvendi Komunal do t'ia rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm së paku dy (2) emra të rinj të cilët i plotësojnë kriteret minimale nga lista e të gjithë kandidatëve të përshtatshëm të siguruar nga Drejtori i Përgjithshëm. Kuvendi Komunal mund t'i radhitë kandidatët e rekomanduar sipas preferencës. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të rekomandimeve, Drejtori i Përgjithshëm do t'ia përcjellë Ministrisë së Punëve të Brendshme emrat e të gjithë kandidatëve të rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Drejtori i Përgjithshëm mund ta shpreh preferencën e tij për emrat e rekomanduar nga Kuvendi Komunal. Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta emëroj një kandidat nga emrat e rekomanduar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të listës.

4. Nëse brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm, Kuvendi Komunal nuk i jep rekomandimet e kërkuara sipas këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm është i autorizuar ta përcjell tek ministria listën me të gjithë kandidatët e përshtatshëm për pozitën e Komandantit të stacionit ose Komandantit të nënstacionit pa rekomandimin e Kuvendit Komunal. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dërgimit të listës te ministria, Drejtori i Përgjithshëm do ta njoftoj Kuvendin Komunal se e tërë lista është përcjellë te ministria për emërim të kandidatit. Ministria do të emëroj ndonjërin kandidat nga kjo listë. Gjatë procesit të emërimit, ministria duhet t'i ketë parasysh nevojat dhe brengat e komunitetit lokal lidhur me shërbimet policore.

5. Përrjashtimisht procedurës së emërimit të komandantëve të stacionit ose nënstacioneve të parapara në këtë nen, për të gjitha çështjet tjera duhet të aplikohen dispozitat e parapara me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore.

## **Neni 43**

### **Procedurat disiplinore për personelin policor**

1. Të gjitha shkeljet disiplinore, ku përfshihet punonjësi i Policisë së Kosovës, përveç rasteve të parapara në Ligjin për Inspektoratin Policor hetohen dhe vendoset nga Policia e Kosovës.

2. Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore rregullohen me akt nënligjor.

**KREU V**  
**MARRËDHËNIA E PUNËS**

**Neni 44**  
**Punësimi i personelit policor**

1. Policia e Republikës së Kosovës punëson tri kategori të personelit policor:

1.1. zyrtarë policorë që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe t'i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore;

1.2. staf civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtroj autorizime policore;

1.3. kadet policor.

2. Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor.

**Neni 45**  
**Gradat dhe funksionet e zyrtarëve policorë**

1. Sistemi i gradimit për zyrtarët policorë, është në përputhje me gradat vijuese:

1.1. polic i ri;

1.2. polic;

1.3. polic i lartë;

1.4. rreshter;

1.5. toger;

1.6. kapiten;

1.7. major;

1.8. nënkolonel;

1.9. kolonel.

2. Zyrtarët policor të emëruar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm ose të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm pas përfundimit të mandatit rimarrin gradën e mëparshme të cilën e kanë pasur para emërimit në këto pozita.

**Neni 46**  
**Të drejtat dhe kufizimet e personelit policor**

1. Personeli policor, gëzon të drejta të njëjta civile dhe politike sikurse qytetarët e tjerë, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve në këtë ligj që janë të nevojshme për ushtrimin efektiv të autorizimeve dhe detyrave policore në shoqërinë demokratike.

2. Personeli policor gëzon të drejta të njëjta sociale dhe ekonomike sikurse shërbyesit e tjerë publikë, siç janë e drejta për të organizuar apo për të marrë pjesë në organizata përfaqësuese dhe t'i pranojnë shpërblimet e duhura, sigurimin social, ndihmën juridike, beneficione shëndetësore dhe beneficione të tjera për punën e tyre.

3. Personeli policor nuk ka të drejtë të bëjë grevë, por ka të drejtë t'i shprehë pakënaqësitë e tij nëpërmjet protestave të organizuara dhe të udhëhequra nga organet përfaqësuese.

#### **Neni 47**

#### **Paga dhe kompensimi për personelin policor**

1. Kompensimi për zyrtarët policor ka parasysh kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat e tyre. Paga themelore e zyrtarëve policor ndryshon duke u bazuar në faktorët përfshirës, por jo të kufizohet vetëm me gradën dhe kohëzgjatjen e shërbimit.

2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione. Pagesat e tilla shtesë bazohen në faktorët duke përfshirë, por jo të kufizohen vetëm në detyrat e rrezikshme, punën nën stres, punën jashtë orarit, orarin e punës me ndërime, punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi, caktimin në punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta.

3. Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe beneficionet e pensionit.

4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj.

5. Përveç pensionit invalidor që e gëzojnë në bazë të ligjit në fuqi, zyrtarët policor të cilët bëhen invalid në kryerje të detyrës apo në detyrë kanë të drejtë në pension invalidor 20% të pagës bruto.

#### **Neni 48**

#### **Kompensimi për vdekje në detyrë apo në kryerje të detyrës**

1. Policia paguan shpenzimet e ceremonisë së varrimit për zyrtarin policor që vdes në detyrë apo në kryerje të detyrës. Vendvarrimi do të caktohet nga anëtarët e familjes së zyrtarit policor. Policia do t'i paguajë shpenzimet në vijim:

- 1.1. transportin për bartjen e kufomës;
- 1.2. shpenzimet e udhëtimit për dy (2) persona shoqërues;
- 1.3. shpenzimet e funeralit që nuk janë paguar në forma të tjera;
- 1.4. shpenzimet e tjera me aprovimin e ministrit.

2. Policia do të paguaj bashkëshortin apo fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në detyrë apo në kryerje të detyrës me një ndihmë financiare të menjëhershme në një shumë që është e barabartë me pagën mujore bruto të shumëzuar me gjashtë. Një pagesë e tillë do të bëhet vetëm pasi të përcaktohet se bashkëshorti apo fëmijët kanë qenë të përkrahur nga zyrtari policor para vdekjes së tij ose saj. Në raste të caktuara sipas vlerësimit, Qeveria mund të ndaj shumë më të lartë financiare të menjëhershme për zyrtarin policor i cili ka vdekur në kryerje të detyrës.

3. Bashkëshorti i/e cili/a përcaktohet që ka qenë e përkrahur nga zyrtari policor dhe fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në kryerje të detyrës kanë të drejtë në pension familjar, por vetëm deri në vlerën 80% të pagës bruto.

4. Bashkëshorti i/e cili/a përcaktohet që kanë qenë e përkrahur nga zyrtari policor dhe fëmijët nën moshën tetëmbëdhjete (18) vjeçare të zyrtarit policor i cili vdes në detyrë kanë të drejtë në pension familjar, por vetëm deri në vlerën 60% të pagës bruto.

5. Me propozimin e Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme, Qeveria nxjerr akt nënligjor për përcaktimin e rasteve të zyrtarëve policor të cilët vdesin në detyrë apo në kryerje të detyrës.

#### **Neni 49** **Konflikti i interesave**

1. Personeli policor nuk do të pranojë një pozitë apo obligim, dhe nuk do të jetë pjesëmarrës në çfarëdo funksioni apo aktiviteti, i cili krijon konflikt të interesave me detyrat zyrtare të policisë. Pozitat dhe aktivitetet që formojnë konflikt të interesave përfshijnë por nuk kufizohen me:

1.1. emërimi apo zgjedhja në detyrë publike apo pozitë tjetër qeveritare;

1.2. pjesëmarrja në fushata elektorale për zgjedhje në detyrë publike;

1.3. punësimi, apo pjesëmarrja në çfarëdo aktivitet biznesi për kompensim, përveç me leje të dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm;

1.4. pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike, ndjekja e udhëzimeve nga cilado parti politike në kryerjen e detyrave policore; paraqitja me uniformë policore në çfarëdo tubimi politik, përveç kur është në detyrë zyrtare policore (anëtarësimi i thjeshtë në një parti politike nuk është konflikt i interesave), dhe

1.5. dhënia e deklaratave publike apo komenteve lidhur me punën e policisë, përveç në raste kur lejohet nga eprori me autorizim të duhur.

#### **Neni 50** **Caktimi i zyrtarit policor në detyrë jashtë shtetit**

1. Zyrtari policor mund të caktohet jashtë shtetit në detyrë si pjesë e punës së tij ose saj të rregullt në mënyrë që të mbështes bashkëpunimin me autoritetet ndërkombëtare kompetente ose organizatat ndërkombëtare.

2. Caktimi në detyrë jashtë shtetit mund të bëhet vetëm me pëlqimin e zyrtarit policor.

3. Caktimi jashtë shtetit zbatohet siç parashihet në marrëveshjen ndërkombëtare, nënshkruese e së cilës është Republika e Kosovës.

### **KREU VI** **FINANCIMI**

#### **Neni 51** **Buxheti i policisë dhe menaxhimi financiar**

1. Policia do të ketë buxhetin e saj, i cili është buxhet i ndarë në kuadër të ministrisë, të miratuar në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

2. Drejtori i Përgjithshëm përgatit buxhetin e policisë, të cilin pastaj ia përcjell ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm në përputhshmëri me procedurat e parapara me ligj.

3. Policia është përgjegjëse për implementimin dhe menaxhimin e buxhetit.

**Neni 52**  
**Fondet e veçanta të policisë**

1. Buxheti i policisë duhet ta ketë një shumë të caktuar për fonde të veçanta për tu përdorur për pagesën e shpërblimeve, pagesën e informatorëve, pagesën për mbrojtjen e dëshmitarëve, dhe pagesën e operacioneve tjera të veçanta policore.
2. Fondet e përshkruara në paragrafin 1. të këtij neni do të administrohen nga Drejtori i Përgjithshëm në pajtim me aktet nënligjore të nxjerra nga ministri për udhëheqjen, menaxhimin dhe shpenzimin e fondeve të tilla.

**Neni 53**  
**Përgjegjësia për dëmin ose lëndimin**

1. Zyrtari policor raporton tek mbikëqyrësi i tij apo saj çdo dëm apo lëndim që ai apo ajo ka shkaktuar gjatë kryerjes së detyrave policore të tij/saj.
2. Në përputhje me ligjin në fuqi, Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë përgjegjëse për dëmet apo lëndimet e shkaktuara personave fizik ose juridik si rezultat i veprimeve të zyrtarëve policorë në kryerjen apo në ndërlidhje me kryerjen e detyrave policore.

**Neni 54**  
**Medaljet, lëvdatat, shpërblimet dhe mirënjohjet**

1. Kryeministri, Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje, zyrtarëve policorë, punëtorëve të tjerë të policisë, personave fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre.
2. Kryeministri jep medaljen në vijim:
  - 2.1. medaljen e nderit.
3. Ministri jep medaljet në vijim:
  - 3.1. medaljen për merita;
  - 3.2. medaljen për trimëri; dhe
  - 3.3. medaljen e shpëtimit të jetës.
4. Drejtori i Përgjithshëm jep medaljet në vijim:
  - 4.1. medaljen për mburojë të policisë;
  - 4.2. medaljen për shërbim të dalluar;
  - 4.3. medaljen policore për lëvdim; dhe,
  - 4.4. medaljen për shërbim të besnikërisë.

**KREU VII**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 55**  
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore, për:

- 1.1. mënyrën e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore, siç përshkruhet në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji;
- 1.2. përdorimin e forcës nga zyrtarët policorë, siç përshkruhet në nenin 26 të këtij ligji;
- 1.3. përdorimin e armëve të zjarrit nga zyrtarët policorë, siç përshkruhet në nenin 27 të këtij ligji;
- 1.4. standardet dhe metodat për mbledhjen, ruajtjen, përdorimin dhe fshirjen e të dhënave personale të mbajtura nga policia, siç përshkruhet në nenin 31 të këtij ligji;
- 1.5. kualifikimet e nevojshme dhe angazhimi i policisë rezervë siç përshkruhet në nenin 36 të këtij ligji;
- 1.6. shkeljet, masat dhe procedurën disiplinore, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 43 të këtij ligji;
- 1.7. marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji;
- 1.8. procedurën e gradimit për personelin policor;
- 1.9. llojet e lëvdatave, shpërblimeve dhe mirënjohjeve, siç përshkruhet në paragrafin 3. të nenit 54 të këtij ligji; dhe
- 1.10. drejtori i përgjithshëm do të nxjerr akte nënligjore më qëllim përkrahjes së bashkëpunimit në mes të kuvendit komunal dhe komunitetit në pajtim me këtë nen, dhe do të përkrahë funksionalitetin e plotë të Komiteteve për Siguri dhe Bordeve.

2. Ministri nxjerr aktet nënligjore, për:

- 2.1. themelimin, përbërjen dhe procedurën e komisionit, sipas paragrafit 8. të nenit 37 të këtij ligji;
- 2.2. menaxhimin dhe shpenzimin e fondeve të veçanta policore; dhe
- 2.3. kriteret dhe procedurat e dhënies së medaljeve shpërblyese, sipas paragrafit 2. të nenit 54 të këtij ligji.

3. Qeveria me propozimin e Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme nxjerr akt nënligjor për mënyrën e ofrimit të ndihmës organeve qeveritare, siç përshkruhet në nenet 7, 8 dhe 9 të këtij ligji.

**Neni 56**  
**Dispozitat e aplikueshme**

Të gjitha çështjet të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj dhe aktet nënligjore që janë në fuqi, vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në nxjerrjen e akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj.

**Neni 57**  
**Afati për nxjerrjen e akteve nënligjore**

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

**Neni 58**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr.03/L-035 për Policinë dhe të gjitha aktet nënligjore që burojnë prej tij, përveç nëse është thënë ndryshe me këtë ligj.

**Neni 59**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-076**  
**2 mars 2012**

**Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.**